



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.52

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i GJK
nr.11, datë 17.5.2006

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.404 Akti, datë 25.07.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr.170, datë 09.12.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1587, datë 27.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) si antikushtetuese

1515

.....

Vendim i GJK
nr.12, datë 18.5.2006

Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.559, datë 13.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; nr.234, datë 17.11.2004 të Gjykatës, si të papajtueshme me Kushtetutën...

1518

Vendim i GJK
nr.13, datë 18.5.2006

Me objekt shfuqizimin i vendimeve nr.4357, datë 05.11.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.600, datë 13.05.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.974, datë 07.05.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese

1520

.....

V E N D I M
Nr.11, datë 17.5.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 01.11.2005, 21.11.2005 dhe 06.12.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.45/4 Akti që i përket:

KËRKUES:SHPK “CIPA” në likujdim e sipër, përfaqësuar nga likujdatori Berti Pashko, si dhe avokate Flonia Tashko (Boriçi), me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. SHPK “GEMINI”, përfaqësuar nga avokate Liljana Ruli, me prokurë.
2. SHPK “INERTE TAPIZË”, në mungesë.
3. FREDDIO DOMENICO, përfaqësuar nga avokat Kujtim Lloha, me prokurë.
4. NERI LORENZO, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.404 Akti, datë 25.07.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, nr.170, datë 09.12.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1587, datë 27.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).

Kërkuesi, duke pretenduar se gjykatat kanë zhvilluar proces jo të rregullt ligjor, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve të mësipërme:

- Gjykatat nuk kanë thirrur në gjykim likuidatorin e shoqërisë “CIPA” sh.p.k., si përfaqësues legjitim të kësaj shoqërie, por kanë thirrur ish-administratorët e saj që nuk ishin më përfaqësues të shoqërisë.

- Gjykatat kanë cenuar parimin e barazisë dhe të kontradiktoritetit në gjykim si përsa i përket mosthirrjes së përfaqësuesit të ligjshëm (likuidatorit), ashtu edhe përsa i përket marrjes e vlerësimit të provave, sepse të thirrurit si përfaqësues nuk kishin interes t’i paraqesnin ato.

- Gjykata e apelit nuk ka pranuar ankimin e “Inerte Tapizë” si ortakë themeluese e sh.p.k. “CIPA”.

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) ka vendosur mospranimin e rekursit, megjithëse në të ishin ngritur probleme që kishin të bënin me zbatimin e ligjit procedural e material, ku ndër më kryesoret ishte zhvillimi i gjykimit në mungesë të përfaqësuesit ligjor.

Përfaqësuesi i Freddio Domenico dhe përfaqësuesja e “Gemini” sh.p.k., kanë paraqitur këto shkaqe për mospranimin e kërkesës:

- Kërkuesi nuk ka bërë përpjekjet për t’i shtrërrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

- Vendimi që kërkohet të deklarohet antikushtetues, është vendim i ndërmjetëm dhe nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese.

- Kërkuesit i ka mbaruar mandati si likuidator i shoqërisë para gjykimit të çështjes dhe nuk mund të përfaqësonte shoqërinë në asnjë instancë gjyqësore.

- Nuk ka shoqëri “Inerte Tapizë” si shoqëri më vete, sepse ortakët e saj i kanë shitur kuotat e tyre katër ortakëve të sh.p.k. “CIPA” dhe i kanë dhënë tagrin e përfaqësimit administratorit Freddio Domenico.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoj relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesin që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e ish-administratorit Freddio Domenico, avokatin Kujtim Lloha dhe përfaqësuesen e subjektit të interesuar sh.p.k. “Gemini”, avokaten Liljana Ruli, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe bisedoi çështjen në tërësi;

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin nr.320, datë 01.11.1999, që ka marrë formë të prerë, ka vendosur deklarimin e pavlefshëm të Shoqërisë “CIPA” sh.p.k. që nga momenti i krijimit të saj, kthimin në gjendjen e mëparshme, si dhe cilësimin e “CIPA” sh.p.k., si shoqëri në likuidim e sipër, duke caktuar edhe likuidatorin. Mbi kërkesën e sh.p.k., “Gemini”, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr.404 Akti, datë 25.07.2003, ka vendosur hapjen e procedurave të falimentimit për sh.p.k., “CIPA”, duke caktuar si administratorë të falimentimit ish-administratorët e kësaj shoqërie.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.170, datë 09.12.2003, nuk ka pranuar ankimin e ortakut “Inerte Tapizë” kundër vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1587, datë 27.07.2004, nuk ka pranuar rekursin e ortakut të lartpërmendur, duke mos e kaluar çështjen në seancë plenare.

- Gjykata Kushtetuese shqyrtoi, në radhë të parë, pretendimet e përfaqësuesit të ish-administratorit të shoqërisë “CIPA” sh.p.k., dhe përfaqësueses të subjektit të interesuar, “Gemini” sh.p.k., sipas të cilëve kjo Gjykatë nuk ka kompetencë të shqyrtojë papajtueshmërinë me Kushtetutën të vendimeve për hapjen e procedurave të falimentimit, përderisa ato janë vendime të ndërmjetme dhe çështja është ende në shqyrtim e sipër.

Gjykata Kushtetuese, në çështjen në shqyrtim, konstaton se me vendimin nr.404 Akti, datë 25.07.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka vendosur për probleme të cilat nuk mund të diskutohen më në gjykimet e mëpasme sh.p.k., si: hapja e procedurës së falimentimit të shoqërisë “CIPA” sh.p.k., caktimi i administratorëve të falimentimit e mbikëqyrësin përkatës, si dhe urdhërimi i publikimit të vendimit. Për këto probleme ky vendim ka marrë formë të prerë. Në gjykimet e mëtejshme në gjykatën e rrethit gjyqësor e në instancat e tjera gjyqësore, shqyrtohen problemet e llogarive që ortakët kanë me të tretët e me njëri-tjetrin, si dhe mbyllja e likuidimit.

Duke interpretuar nenin 131/f të Kushtetutës për kompetencën e saj në gjykimin e çështjeve konkrete, Gjykata Kushtetuese nuk ka pranuar për shqyrtim rastet kur gjykimi i çështjes nuk ka përfunduar, por vazhdon, dhe pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese të procesit mund të korrigjohen gjatë rigjyimit. Në rastin në shqyrtim, meqenëse vendimet, objekt kërkesë, kanë vendosur për probleme që nuk mund të diskutohen më në gjykimet e mëtejshme sepse për to gjykimi ka përfunduar, shqyrtimi i kërkesës për shfuqizimin e këtyre vendimeve hyn në sferën e kompetencave të saj, parashikuar në nenin 131/f të Kushtetutës.

Përfaqësuesi i ish-administratorit, si dhe ajo e subjektit të interesuar pretendojnë gjithashtu se kërkuesi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse nuk i ka shterrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese e ligjore. Sipas tyre, ai nuk ka paraqitur ankim në shkallët më të larta gjyqësore, megjithëse ka pasur dijeni për vendimet gjyqësore objekt kërkesë.

Nga zhvillimi i gjyimit, si dhe nga dokumentacioni i ndodhur në dosjen gjyqësore, nuk rezulton që të jenë njoftuar për gjykimet e çështjeve sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile likuidatori Përparim Kasa, i caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin nr.320, datë 01.11.1999, ashtu edhe likuidatori Berti Pashko që ka zëvendësuar të parin sipas vendimit nr.42, datë 18.07.2000 të asaj gjykate. Atyre nuk u është komunikuar kërkesëpadia dhe vendimet e marra nga gjykatat, prej të cilave do të krijohej mundësia për të organizuar mbrojtjen e për të bërë ankim në instancat më të larta të sistemit gjyqësor. Meqenëse këto të drejta të kërkuesit nuk janë respektuar nga gjykatat, nuk mund të pranohet edhe pretendimi i subjekteve të interesuara se kërkuesit nuk i kanë shterrur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Gjykata Kushtetuese e konsideron si të pabazuar edhe pretendimin e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, sipas të cilit nuk duhet të thirrej në këtë gjykim kushtetues “Inerte Tapizë”, pasi nuk është shoqëri tregtare, si dhe pretendimin e përfaqësuesit të ish-administratorëve sipas të cilit “Inerte Tapizë” duhet të përfaqësohet nga ortakut Freddio Domenico.

Gjykata Kushtetuese shqyrton ankesën e likuidatorit, me pretendimet se gjykatat kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor prandaj në gjykimin e çështjes, duhet të thërriste ndërgjyqësit e thirrur në ato çështje. “Inerte Tapizë” jo vetëm që figuron si “palë e interesuar” në gjykimin në apel e në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por natyra e saj juridike është përcaktuar në vendimet gjyqësore që kanë marrë formë të prerë si “shoqëri me bashkëpronarë”, ku pasuria u takon bashkëpronarëve në pjesë. Si rrjedhojë, ajo, është legjitimuar si palë në gjykim, por nuk mund të përfaqësohet nga një ortak ose administrator pa aktpërfaqësimin e shprehur të secilit bashkëpronar.

- Përsa i përket pretendimeve të kërkuarve se gjykatat e sistemit gjyqësor kanë zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, në çështjen me objekt hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “CIPA” sh.p.k., nuk e ka thirrur në gjykim si palë shoqërinë dhe as ortakët e saj, duke u cenuar të drejtën e mbrojtjes. Lidhur me thirrjen e praninë e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut është shprehur: “Prania e palëve në një proces civil ..., është një karakteristikë e rëndësishme e garancive të parashikuara në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në lidhje me çështjet civile, gjykata ka vendosur se kjo është veçanërisht e rëndësishme kur probleme të një natyre faktike ose personale janë vënë në lojë ...”.¹

Gjykata e Apelit Tiranë ka thirrur si palë të interesuara shoqërinë “CIPA” sh.p.k., dhe “Inerte Tapizë”, që figuron si një prej ortakëve të shoqërisë. Megjithatë edhe kjo gjykatë ka cenuar të drejtën e palëve për të marrë pjesë në një proces të barabartë ku të kenë të drejtë të paraqesin provat e komentet rreth tyre sepse thirri në gjykim si përfaqësues të shoqërisë dy ish-administratorët e saj. Pasi mori formë të prerë vendimi nr.320, datë 01.11.1999, që e shpalli të pavlefshme shoqërinë që nga krijimi e caktoi likuidatorin, shoqëria duhej të përfaqësohej nga likuidatori dhe jo nga ish-administratorët. Ky i fundit jo vetëm ishte përfaqësues i vërtetë i shoqërisë, i caktuar më parë me vendim të formës së prerë të gjykatës, por në çështjen konkrete do të dilte si mbrojtës i interesave të gjithë shoqërisë dhe jo i ortakëve të veçantë të saj. Dy administratorët e thirrur nga gjykata, jo vetëm nuk kishin të drejtë ta përfaqësonin shoqërinë “CIPA” sh.p.k., pas dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë për shpalljen të pavlefshme të shoqërisë që nga momenti i krijimit, por duke qenë njëkohësisht edhe ortakë të kreditorit (“Gemini” sh.p.k.), kishin interesa për pranimin e padisë, gjë që i hapte rrugë cenimit të parimit të barazisë së mjeteve në procesin e paraqitjes dhe të interpretimit të provave.

Përfaqësuesi i ish-administratorëve si dhe i subjektit të interesuar, duke mos pranuar cenimin e procesit të rregullt ligjor nga gjykatat, pretendojë se këta të fundit, me të drejtë, nuk e thirrën likuidatorin e shoqërisë, sepse atij i kishte mbaruar afati 3-vjeçar i parashikuar në nenin 283 të ligjit “Për shoqëritë tregtare” dhe si i tillë, nuk mund të përfaqësohte në gjyq shoqërinë.

Afati i mandatit të likuidatorit, duke qenë me karakter disiplinor, fillon nga dita kur përmbaruesi gjyqësor, për zbatimin e vendimit gjyqësor, i dorëzoi atij dokumentet me inventarin e shoqërisë. Sipas procesverbalit “Mbi veprimet e kryera dhe shpenzimet e bëra gjatë ekzekutimit” dhe vendimit “Për pushimin e urdhrit të ekzekutimit” të zyrës së përmbarimit Krujë rezulton se dokumentacioni i shoqërisë me inventarin e pasurisë i janë dorëzuar likuidatorit më datë 07.08.2003, d.m.th., para gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë. Përderisa kishte vendime gjyqësore të formës së prerë që kishin caktuar si administratorë të shoqërisë likuidatorët Përparim Kasa e më pas Berti Pashko, gjykata e apelit nuk mund të legjitimonte si përfaqësues të shoqërisë persona të tjerë kur vendimet e mëparshme nuk ishin shfuqizuar. Duke mos respektuar ato vendime dhe madje duke vepruar në kundërshtim me to, gjykata cenoj parimin kushtetues të fuqisë detyruese të vendimeve të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

¹ Vendimi “Krombach kundër Francës”, datë 03.02.2001, fq.

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.404 Akti, datë 27.05.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë; nr.170, datë 09.12.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1587, datë 27.07.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr.12, datë 18.5.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 13.02.2006 dhe 28.02.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.50/9 Akti që i përket:

KËRKUES: ZAMIR BASHLI, përfaqësuar nga avokat Artan Haxhiu, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: RUSTEM HASAJ, përfaqësuar nga avokat Arben Qeleshi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.559, datë 13.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr.234, datë 17.11.2004 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.1159, datë 08.07.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimeve:

1. Gjykatat kanë kryer shkelje të dispozitave procedurale që kanë të bëjnë me formimin e trupit gjykues.

2. Paditësi Rustem Hasaj nuk legjitimohej në ngritjen e padisë.

3. Gjykata e rrethit dhe ajo e apelit kanë vendosur tej objektit të padisë. Ndërsa në padi është kërkuar kthimi i sendit, gjykatat kanë vendosur edhe njohjen e pronësisë.

4. Gjykatat nuk kanë pasur parasysh se në gjykimin e çështjes ka “gjë të gjykuar”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Alfred Karamuço, përfaqësuesit e kërkuesit dhe të subjekteit të interesuar, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Subjekti i interesuar Rustem Hasaj, me anën e procesit të privatizimit të pronës shtetërore është bërë pronar i një trualli në periferi të qytetit të Shkodrës, me sipërfaqe prej 10.195 m² si dhe i disa ndërtesave që ndodheshin aty, vërtetuar me aktin e pronësisë nr.1948, datë 16.11.1993.

Më pas, kjo pronë ka kaluar në pronësi të personave të tjerë, të cilët në vitin 1995 ia kanë shitur kërkuesit Zamir Bashli, regjistruar në regjistrin e pronësisë me nr.1189, datë 08.08.1995, regjistruar në regjistrin e pronësisë me nr.1070, datë 18.05.1994.

Në nëntor 2003, subjekti i interesuar Rustem Hasaj, ka ngritur padi kundrejt kërkuessit Zamir Bashli për kthimin e pronës, duke e bazuar kërkimin shprehimisht në nenin 296 të Kodit Civil.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.559, datë 13.04.2004, ka vendosur njohjen e pronësisë së subjektit të interesuar mbi objektin dhe kthimin e saj. Këtë vendim e ka lënë në fuqi Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin e saj nr.234, datë 07.11.2004. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1159, datë 08.07.2005, nuk ka pranuar për shqyrtim rekursin e paraqitur nga kërkuessi.

Gjykata Kushtetuese arrin në përfundim se vendimet e atakuara janë rrjedhojë e një procesi të parregullt gjyqësor e si të tilla, ato duhet të shfuqizohen.

Gjykimi i çështjeve nga një gjykatë e përcaktuar me ligj përbën një ndër elementet e procesit të rregullt ligjor si në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, ashtu dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në përputhje me përmbajtjen dhe frymën e këtyre dokumenteve, “gjykata e caktuar me ligj” ka të bëjë jo vetëm me bazën ligjore për vetë ekzistencën e një gjykate, por edhe me përbërjen e trupit gjykues në secilin rast.

Në legjislacionin e brendshëm, e veçanërisht në Kodin e Procedurës Civile janë parashikuar një sërë rregullash, të cilat në tërësinë e tyre burojnë nga aktet e mësipërme dhe me zbatimin e tyre sigurojnë respektimin e parimit kushtetues të gjykimit të drejtë. Kështu, në nenet 154 e 154/a të Kodit të Procedurës Civile, pranimi për shqyrtim i padisë lidhet me plotësimin e të gjithë treguesve të saj, përfshirë dhe vlerën e padisë dhe kjo e fundit determinon në caktimin e përbërjes të trupit gjykues (nenet 35 e 65 të Kodit të Procedurës Civile).

Duke iu referuar çështjes në shqyrtim, rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër është paraqitur një padi për kthim sendi, pa përcaktuar as vlerën dhe as përmasat e këtij sendi. Nga shqyrtimi i dosjes, nuk del të ketë ndonjë kërkim nga palët apo ndonjë veprim nga gjykata lidhur me përcaktimin e vlerës për efekt të gjykatës kompetente. Konstatohet gjithashtu se gjykata ka administruar si prova shkresore një sërë dokumentesh ku është pasqyruar jo vetëm sipërfaqja e objektit, por edhe vlera e tij e tregut në periudha të ndryshme kohe (7 785 000 lekë në kontratën e datës 29.11.1993 dhe 50 milionë lekë me kontratën e datës 08.02.1995). Edhe pse në këto kushte, shqyrtimi i çështjes është bërë nga një gjyqtar i vetëm.

Kërkuessi, në ankimin drejtuar Gjykatës së Apelit Shkodër, e ka ngritur këtë si shkelje thelbësore, sepse sipas tij vlera e objekteve ishte mbi 10 milionë lekë e për pasojë çështja duhej të shqyrtohej nga tre gjyqtarë. Ndaj një pretendimi të tillë, gjykata e apelit nuk e ka parë me vend të veprojë vetë, dhe për më tepër, për të rrëzuar këtë pretendim, në vendimin e saj bën një arsyetim sa antiligjor aq edhe alogjik. Në kundërshtim me kërkesat e ligjit, gjykata e apelit arsyeton se palët kanë qenë dakord me përbërjen e trupit gjykues, duke përjashtuar plotësisht përgjegjësinë e vetë gjykatës në formimin e trupit gjykues mbi bazën e vlerës së padisë. Nga ana tjetër, gjykata e apelit shprehet se palët në aktin e shitblerjes nr.12660/2935, datë 29.11.1993, kanë përcaktuar vetë vlerën prej 7 785 000 lekë. Në këtë arsyetim, gjykata e apelit nuk ka parasysh se në kontratë nuk është palë kërkuessi, përkundrazi, ai është palë në kontratën e vitit 1995, ku objekti është vlerësuar me 50 000 milion lekë, kontratë e cila ndodhej në dosje.

Në këtë arsyetim, gjykata e apelit nuk mban parasysh se në këtë kontratë kërkuessi nuk është palë, përkundrazi, ai është palë në kontratën e vitit 1995, ku objekti është vlerësuar me 50 000 lekë, kontratë e cila ndodhej në dosje. Veç kësaj, është për t’u nënvizuar fakti se Gjykata e Apelit Shkodër, ndërsa në faqen 3 të vendimit e konsideron kontratën e vitit 1993 të falsifikuar e të pavlefshme, në faqen 4 të po këtij vendimi vlerën e objektit, sipas kësaj kontrate, e përdor për të rrëzuar pretendimin e kërkuessit për vlerën e padisë. Së fundi, gjykata e apelit e arsyeton këtë pjesë të vendimit haptazi në kundërshtim me nenet 65 e 69 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilave vlera e padisë llogaritet në momentin e paraqitjes së saj në gjykatë dhe se kjo vlerë përcaktohet nga vlera në treg e pronës.

Në përfundim, Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh vlerat e objekteve të përcaktuara që para 10 vjetësh, indeksimin financiar të ndodhur në këto vite, si dhe vetë përmasat e konsiderueshme të objekteve në konflikt, ka krijuar bindjen se në rastin e dhënë nuk ndodhemi para shkeljesh formale juridike pa pasoja, por para shkeljesh, riparimi i të cilave do të realizojë gjykimin e çështjes në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, nga një gjykatë kompetente.

Përsa i përket shkaqeve të tjera të ngritura nga kërkuessi, Gjykata Kushtetuese rezervon të shprehë pikëpamjen e saj, me qëllim që të mos ndikojë në rigjykimin që do t’i bëhet çështjes në tërësi,

duke filluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Është ajo gjykatë që veç përcaktimit të vlerës konkrete të objekteve do të formojë ndërgjyqësinë në përputhje me ligjin, do të gjykojë edhe për ekzistencën ose jo të gjësë së gjykuar, etj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr.559, datë 13.04.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr.234, datë 17.11.2004 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe nr.1159, datë 08.07.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M

Nr.13, datë 18.5.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 20.02.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.15 Akti që i përket:

KËRKUES: XHEMAL KODRA, përfaqësuar nga avokat Arqile Nini, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: TRASHËGIMTARËT E ISLAM AGËS

1. ZENEL AGA, përfaqësuar nga avokat Gjergj Papuli, me prokurë.

2. HANE, KASEM, FATIME, DRITA, LUMTURI, METJE, SILVANA, SHANE E NADIRE AGA, në mungesë.

3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, në mungesë

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.4357, datë 05.11.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.600, datë 13.05.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.974, datë 07.05.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi pretendon se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke arsyetuar në këto drejtime kryesore:

Së pari, çështja nuk është shqyrtuar nga një gjykatë kompetente dhe e parashikuar me ligj, por është gjykuar me gjyqtar të vetëm dhe jo me një trup gjykues. Gjykata nuk ka caktuar ekspert për të

përcaktuar vlerën e padisë, ndërkohë që kërkuuesi e ka bazuar pretendimin e tij në një akt ekspertimi privat, sipas të cilit vlera e objektit të padisë kalon shumë 10 milionë lekë.

Së dyti, gjykata e shkallës së parë nuk ka krijuar drejt ndërgjyqësinë, sepse nuk ka bërë zëvendësimin procedural të palës së paditur që ka vdekur me trashëgimtarët ligjor sipas dëshmisë së trashëgimisë, por sipas certifikatës së lindjes.

Së treti, gjykata e apelit megjithëse, sipas kërkuetit, ka riçelur hetimin gjyqësor për të thirrur në proces pronaren e objekteve mbi truall, me cilësinë e palës së paditur, ajo nuk e ka plotësuar këtë detyrim ligjor.

Së katërti, Gjukata e Lartë nuk e ka kaluar çështjen në seancë, ndërkohë që problemi ligjor ndërmjet të tjerave ka qenë kolizioni ndërmjet ligjit “Për token” dhe ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuetit, të subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjukata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.4357, datë 05.11.2002, në çështjen me objekt “Anulim të vendimit të komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronave” dhe objekt kundërpadie “lirim e dorëzim sendi”, ka rrëzuar padinë e kërkuetit dhe ka pranuar kundërpadinë për të liruar e dorëzuar sipërfaqen e truallit prej 4000 m².

Gjukata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Të gjitha pretendimet e parashtruara nga kërkuuesi, Gjukata Kushtetuese i analizon në drejtim të ndikimit të drejtpërdrejtë që ato mund të kenë sjellë në cenimin ose jo të të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjukata Kushtetuese çmon se pretendimi i kërkuetit për tejkalim të kufirit ligjor të vlerës së padisë, parashikuar nga neni 35 i Kodit të Procedurës Civile, arsye kjo që detyronte gjykatën të shqyrtonte çështjen me një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, nuk është i drejtë nga pikëpamja kushtetuese.

Çështjen në shqyrtim, gjykata e rrethit gjyqësor e ka gjykuar me një gjyqtar të vetëm. Kodi i Procedurës Civile ka parashikuar si një kusht thelbësor për përbërjen e rregullt të trupit gjykues, vlerën në lekë të aktit administrativ që kundërshtohet. Përcaktimi i vlerës së padisë, në rastet e kundërshtimit të paligjshmërisë së akteve administrative, përbën njëkohësisht një element esencial për të konkluduar mbi gjykatën kompetente. Gjukata Kushtetuese çmon se mosrespektimi nga ana e gjyqtarit të vetëm, në momentin e paraqitjes së padisë, të këtij rregulli procedural që kërkon zhvillimi normal i një procesi gjykimi, mund të sjellë cenimin e elementit thelbësor kushtetues që lidhet me gjykatën kompetente.

Por nga dosja gjyqësore rezulton se gjykata e rrethit gjyqësor dhe në veçanti gjykata e apelit e kanë shqyrtuar këtë pretendim të kërkuetit dhe ia kanë refuzuar si të pabazuar. Kështu, nga procesverbali i seancës gjyqësore të zhvilluar në gjykatën e rrethit gjyqësor rezulton se ekspertët i janë përgjigjur pyetjes së gjykatës për çmimin e truallit, objekt gjykimi, duke përcaktuar vlerën e objektit të padisë nën kufirin që parashikon ligji. Këtë pretendim të kërkuetit e ka analizuar gjykata e apelit në vendimin e saj, duke evidentuar se nuk e kalon kufirin ligjor, pasi gjykata e rrethit gjyqësor e ka llogaritur vlerën e objektit të padisë, e cila arrin shumë 6 milionë lekë, me ekspertë.

Në rastin konkret, përcaktimi saktësisht i vlerës së padisë, në raport me kufirin ligjor prej 10 milionë lekë, që parashikon neni 35 i Kodit të Procedurës Civile, është një çështje të provuari që ka dalë gjatë gjykimit në fakt të çështjes dhe, si i tillë, nuk mund të rivlerësohet ndryshe nga Gjukata Kushtetuese.

Në këto kushte, bërja e një analize apo vlerësimi të ri nga ana e Gjykatës Kushtetuese të një prove të administruar në dosjen gjyqësore, që në rastin konkret lidhet me përgjigjen e ekspertëve në seancë gjyqësore mbi vlerën e objektit të padisë, do ta deformonte procesin kushtetues dhe do ta shndërronte atë në një proces gjykimi të zakonshëm. Mbi këtë analizë, Gjukata Kushtetuese çmon se

kërkuesi nuk provon se procesi gjyqësor ka qenë i parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

Pretendimi tjetër i kërkuesit për parregullsinë e procesit gjyqësor, për shkak të mosthirrjes në gjykim të trashëgimtarëve ligjorë sipas dëshmisë së trashëgimisë apo të personave të tjerë të paditur, nuk është i drejtë. Gjykata Kushtetuese vlerëson se ky pretendim duhet analizuar në aspektin e lidhjes së drejtpërdrejtë që ka ekzistenca e shkeljes ligjore me vetë kërkuesin, si dhe të ndikimit që kjo shkelje mund të ketë sjellë mbi ecurinë e procesit gjyqësor. Ky pretendim nuk lidhet me elementet thelbësore që kërkon e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Kuptimi i kësaj të drejte është analizuar gjerësisht në shumë vendime të Gjykatës Kushtetuese, si dhe të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Moskrijimi i drejtë i ndërgjyqësisë që lidhet me parimin e kontradiktoritetit në gjykim, si dhe i barazisë së armëve, është konsideruar nga jurisprudenca shkelje e standardeve, kur ankuesit i është cenuar drejtpërdrejt e drejta për një proces të rregullt ligjor që parashikon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Mosprania në gjykim e personave që, sipas kërkuesit, duhej të thirreshin si të paditur, si dhe zhvillimi i gjykimit në mungesë të tyre, nuk përbëjnë një pretendim kushtetues në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për arsye se ai i ka pasur të gjitha mundësitë të ushtrojë të drejtat e tij në këtë gjykim.

Edhe pretendimi tjetër i kërkuesit që lidhet me parregullsinë e procesit gjyqësor në Gjykatën e Lartë për shkak të mosshqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, por në dhomën e këshillimit, nuk argumentohet në dimensionin kushtetues që kërkon e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe për rrjedhojë duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër qëndrimit të shumicës që ka vendosur për rrëzimin e kërkesës së kërkuesit.

Kërkuesi Xhemal Kodra ka kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.4357, datë 05.11.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr.600, datë 13.05.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.974, datë 07.05.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Ai ka pretenduar se gjykatat i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, sepse çështja është gjykuar nga një gjykatë jo kompetente, nga një gjyqtar në vend që të gjykohej nga një gjykatë e përbërë nga tre gjyqtarë; se nuk është formuar drejt ndërgjyqësia e se nga Gjykata e Lartë nuk janë vlerësuar si duhet problemet e rëndësishme ligjore të parashikuara në rekursin e paraqitur prej tij.

Gjatë shqyrtimit të çështjes është konstatuar se kërkuesit, që në fillim të hetimit gjyqësor, ka paraqitur pretendimin se kërkesa e tij duhej të gjykohej nga një gjykatë e përbërë nga tre gjyqtarë, sepse sipas tij, objekti i padisë është mbi 10 milionë lekë. Veç kësaj, kërkuesi, në mbështetje të pretendimeve të tij, i ka paraqitur gjykatës një akt ekspertimi të kryer në mënyrë private, me të cilin vërtetonte se vlera e padisë ishte 37 milionë lekë.

Në kundërshtim me sa është pretenduar nga kërkuesi, gjykata nuk ka pranuar për të bërë

ekspertizë për këtë problem, i cili duhej zgjidhur në fillim të shqyrtimit të gjykimit. Gjykata ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit në përfundim të gjykimit të çështjes, por dhe atëherë nuk i ka pyetur ekspertët për vlerën e objektit që ishte kontestuar që në fillim të gjykimit. Për këtë pretendim me rëndësi për çështjen në gjykim, krejt rastësisht gjykata në seancë ka pyetur ekspertët në lidhje dhe me vlerën e objektit dhe ata janë shprehur se vlera ishte nën 10 milion lekë.

Duke vepruar në këtë mënyrë, gjykata e rrethit gjyqësor ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile në lidhje me gjykatën kompetente sepse:

Sipas nenit 65 të këtij Kodi, vlera e padisë llogaritet në momentin e paraqitjes së saj në gjykatë; ndërsa sipas nenit 69 të tij, kur kërkohet një pronë e paluajtshme, vlera e padisë përcaktohet nga vlera në treg e pronës që kërkohet.

Ndryshe nga sa parashikojnë këto dispozita, gjykata jo vetëm që nuk ka zgjidhur këtë problem në fillim, por nuk ka pranuar as të verifikojë pretendimin e parashtruar nga kërkuesi gjatë gjykimit. Në këtë mënyrë ajo ka vepruar në kundërshtim edhe me përmbajtjen e nenit 59 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit gjykata në çdo fazë të gjykimit, qoftë dhe kryesisht, merr në shqyrtim juridiksionin apo kompetencën e saj, si dhe të nenit 61 të tij, që përcakton se gjykata, kur konstaton që nuk është kompetente për gjykimin e çështjes, kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.

Sipas këtyre dispozitave, për saktësimin e vlerës së padisë e për përcaktimin e gjykatës kompetente, kanë detyrimet e tyre veçmas si pala që paraqet kërkesëpadinë, ashtu dhe gjykata së cilës i paraqitet kërkesëpadia. Sipas mendimit tim, këtë detyrim duhet ta përmbushë pala që paraqet kërkesën, por nëse ajo nuk e realizon atë si duhet, gjykata duhet të luaj rol aktiv për të përcaktuar vlerën e padisë, pasi me të është i lidhur ngushtë problemi i gjykatës kompetente. Pra, gjykata nuk duhet të jetë indiferente e ta lidhë këtë problem të rëndësishëm vetëm me disponibilitetin e kërkuesit apo dhe të palëve.

Për këto arsye, mendoj se gjykata e rrethit gjyqësor ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Civile për këtë problem dhe gjykata e apelit, pa shkaqe të përligjura, është pajtuar me këtë qëndrim; ndërsa Gjykata e Lartë, këtë pretendim të rëndësishëm me karakter ligjor nuk e ka vlerësuar si shkak për ta kaluar çështjen për gjykim. Në këto rrethana, kërkesa duhej pranuar.

ANËTAR
F. Abdiu

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 22.5.2006
Doli nga shtypi më 24.5.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë